

## DOROTHEA GJIKA E DIANA ÇULIT OSE TRAGJEDIA ABSURDE E ZHULJETËS SHQIPTARE

ROLAND ZISI, VJOLLCA RRAPAI

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Shqipëri  
Email: rolandzisi@yahoo.com; vjollcarapai@yahoo.com

### Përmbledhje

Në këtë artikull synohet të realizohet një interpretim letrar e filozofik mbi figurën e Dorothea Gjikes, njerës prej **personazheve** kryesore të romanit “Ëngjëj të armatosur” të shkrimtares Diana Çuli. Në letërsinë bashkëkohore shqipe, Diana Çuli është një autore e spikatur, me individualitet të fortë artistik në gjininë e prozës dhe me një krijimtari të bollshme e tejet cilësore. Romani rrëfen artistikisht **dashurinë** mes Dorothea Gjikes dhe Aleks Lazarit, dashuri e lindur në kushte lufte si një pasion i madh dhe i sinqertë njerëzor por që përfundon **tragjikisht** për shkak të moralit të vjetër shoqëror dhe mekanizmave vrastare të luftes. Dorothea Gjika është një vajzë plot **ëndërra**, qëllime e **pasione** të larta, një karakter sa i brishtë aq edhe i fortë e i moralshëm. Ajo është viktimë e paragjyqimit shoqëror, heroina e një kohe të jetuar para kohe dhe uvertura e një periudhe totalitare që po konturohej në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Dorothea e Diana Çulit nuk është një femër e zakonshme që përjeton një dashuri të zakonshme; Dorothea fiton artistikisht vlerat e një himni universal për femrën shqiptare, për **emancipimin** dhe **progresin** që lind gjithmonë nga tragjizmi për shkak të “thyerjes së normave **morale**” të shoqërisë.

### 1. Hyrje

Nisur nga përvoja e gjatë krijuese, nga krijimtaria e bollshme në disa kategori të shkrimit letrar dhe sidomos nga vlerat e mëdha estetike që ofrojnë tekstet e saj letrare, shkrimtarja Diana Çuli qëndron sot në rrethin e autorëve më të spikatur dhe originalë të letërsisë sonë, sidomos në zhanrin e romanit. Prej vitesh, përmes tregimeve, novelave e sidomos romaneve ajo ka mundur të krijojë një relacion besimi me publikun e gjerë, me lexuesin e shkolluar, në veçanti me të rinjtë dhe gratë, një lidhje të ndërsjelltë estetike dhe shpirtërore që do ta kishte zili çdo shkrimtar, në çdo kohë dhe në çdo vend. Një nga punët letrare më të suksesshme të D. Çulit që

dëshmon më së miri pohimin tonë të mësipërm është romani “Ëngjëj të armatosur” (Çuli, 2004), i cili me shumë të drejtë është vlerësuar si romani më i mirë i saj dhe gjithashtu si një nga prozat më të bukura të letërsisë sonë. Ky roman shquhet për një veçanti dhe originalitet spikatës në trajtimin e temës së Luftës, megjithëse ai në të vërtetë nuk është roman për zulmën dhe betejat e luftës sepse në argument të parë dhe të fundit ëngjëjt asnjëherë nuk luftojnë me armë. “Ëngjëj të armatosur”, në këtë aspekt, paraqitet si një prozë që zhvlerëson dhe dekurajon qindra vepra të realizmit socialist me këtë temë, duke krijuar njëherazi modelin e një proze moderne, ku suksesi dhe estetika nuk lidhen apo burojnë automatikisht prej **temës** por prej **cilësisë së shkrimit** dhe talentit që mbart në vetvete shkrimtari. Këtë të vërtetë e artikulon vetë autorja kur shprehet se “kur po e shkruaja këtë libër, ndonjë miku im gati më dekurajoi duke më thënë se tema e luftës është e vjetëruar. Për mendimin tim ky argument nuk qëndron, sepse ne shohim me shumë interes filma me luftën e dytë apo me mesjetën etj., lexojmë libra me temë edhe nga koha e egjiptianëve të lashtë. Në një vepër letrare ka rëndësi se çfarë vlere letrare ka vepra, çfarë thotë dhe si e thotë dhe jo se nga cila kohë e merr temën” (Çuli, [www. Zemrashqiptare.net](http://www.Zemrashqiptare.net)).

Romani shkon përgjithësisht rrugës së **realizmit dhe simbolizmit** dhe këto cilësi dëshmojnë si nga elementet e përmbajtjes ashtu dhe nga disa treguesit formalë siç janë titulli “Ëngjëj të armatosur”, apo emra personazhesh që etimologjikisht sugjerojnë simbolika të caktuara dhe tepër domethënëse, siç është përshebull emri që mban personazhja kryesore, Dorothea. “Ëngjëj të armatosur”, i menduar si një pranëvënie antinomike kontekstuale paradoksalisht realiste, funksionon si një titull që rrezaton simbolikisht skaje që e kanë të pamundur të bashkohen sepse misioni i ëngjëjve nuk është arma. Të dy këto paradigma nuk e pranojnë njera tjetrën, madje janë të kundëtat e njera-tjetrës. Ndërkaq sintagma

emërore Dorothea na ndihmon që, gjatë leximit dhe sidomos gjatë analizës së veprës, të kuptojmë dhe të ndërtojmë një filozofi të tërë, tepër të qartë e të; sintagma Dorothea, ose (nga greqishtja) Dhuratë e Zotit, e shtyn lexuesin të besojë dhe arsyetojë se Jeta, qoftë edhe e një njeriu të vetëm, duke qenë predikat i sferës së epërme hyjnore, nuk mund të tjetërsohet apo mohohet nga tokësorët e çfardoshëm këtu poshtë. Njeriu vjen në jetë për ta gëzuar atë dhe askush nga tokësorët nuk ka të drejtë ta ndryshojë këtë destinacion. Çrregullimi i kësaj ligjësie sa hyjnore aq edhe realiste e filozofike përbën boshtin themelor të romanit dhe problemin me të cilin ai merret nga fillimi në fund.

Një element tjetër që bie në sy pareshtur është kompozicioni strukturor i romanit, mënyra e paraqitjes së ngjarjeve apo thënë ndryshe arkitektura narrative origjinale e tij. Në pikëpamje formale, ndryshe nga romanet apo prozat e tjera të kësaj autoreje në të cilat propozohet një ligjërim linear e kronologjik, me një narrator kryesor dhe të gjithëdijshëm, në “Ëngjëj të armatosur” shfaqet një ligjërim i copëzuar, i ndërprerë dhe i përçarë, duke bërë që narracioni të jetë kompetencë e disa zërave rrëfyes. Këtë situatë ligjërimore e ka kondicionuar konceptimi i shkrintares për të operuar me ditarët, kujtimet, shënimet, kronikën, procesverbalet etj. të cilat të gjitha sëbashku formojnë një teknikë shkrimi moderniste e cila konsiston në përçarjen e narracionit kronologjik dhe fragmentimin (copëzimin) e tij. Vetë autorja është pozicionuar në statusin e njërit prej narratorëve, konkretisht të motrës së Dorotheas e cila merr përsipër të jetë edhe ndërlidhësja kryesore e pjesëve të romanit: “Nestori kishte lënë shumë dorshkrime, pjesë ditari, dokumenta të zgjedhur nga vjetërsia, letërkëmbime, të future në një kuti kartoni, në kapakun e së cilës kishte shënuar: Dorothea. Për Rozalinë. E shoqja ma dha kutinë e kartonit ditën e varrimit dhe unë e hapa atë në darkë vonë, në shtëpin time. Në atë kuti kishte gjithçka më duhej për ta ngritur më në fund murin.

Më ndihmoi shumë ditari i xhaxhait tim Niqiforit, shoqëruar me shënimet e Nestorit. Këto shënime që i kishte bërë cilitdo dokumenti, më pëlqyen shumë nga mënyra se si ai largohej nga fakti dhe pastaj e interpretonte atë. Përdora metodën e Nestorit për të paraqitur versionin tim, prandaj dhe ky libër është si një koncert në piano me katër duar (Çuli, 2004: 5-6).

Në pikëpamje narrative romani është një ansambël zërash rrëfyes, që u ngajnë një vargu kamerash të vendosura në kuota të ndryshme por që përcjellin po të njëjtën ngjarje, nga këndvështrime dhe fokalizime të ndryshme. Të gjitha këto argumenta paraprake por

dhe të tjera që lidhen me shtresa e shtresëzime romanësore e literale të veprës dëshmojnë dhe justifikojnë vlerat estetike të saj, rëndësinë peshën apo universalitetin e mesazheve si dhe ndikimin që ky roman ka dhe vijon të ketë ndër lexues.

## 2. Letërsia dhe femra

Shumë libra janë shkruar për femrat, shumë autorë në letërsinë botërore nuk kanë reshtur së shkruari rreth natyrës magjike dhe personalitetit njerëzor të femrës. Të tjerë, natyrshëm, ende vijnë ta bëjnë këtë gjë duke i konceptuar ato si kufiri simbolik që përmbajnë tipare turbulluese e kaotike të të gjitha niveleve, ndikime të çuditshme tek meshkujt dhe tek shoqëria, të të gjitha llojeve. Dhe gjithmonë ajo, domethënë femra, vijon të mbetet një subjekt sa i njohur shumë aq dhe i njohur pak ose aspak. Kjo është arsyeja që shpesh në shoqëritë ku mbisundon kultura mashkullore, femrat të konsiderohet herë-herë si krijesa të vlefshme ose të pazëvendësueshme dhe herë-herë si përfaqësuese të negativitetit dhe anarkisë. Kështu vazhdon të tirret kjo temë e madhe e përjetëshme, pra tema e femrës, duke i paraqitur ato diku-diku si heroina, virgjëresha ose nëna, pra si modele emancipimi, diku-diku si Lolita të pafajshme por turbulluese e diku-diku si lavire të Venedikut apo Babilonisë ([www.exbaba.it/alkune](http://www.exbaba.it/alkune)) që çorientojnë rregullin dhe sensin e shoqërisë njerëzore.

Jo pak vepra me temën e femrës dhe dashurisë që ajo posedon në vetvete janë shkruar edhe në literaturën shqipe. Duke qenë të veçanta shoqëria, historia dhe kultura jonë rrjedhimisht specifike kanë qenë dhe janë këto vepra, pikësëpari se janë produkt i një zinxhiri të gjatë rrethanash historike antifemërore e jociivilizuese. Në botën tonë kulturore, në mënyrë permanente, qysh prej legjendës së flijimit të Rozafës, tek “Sikur të isha djalë” i Haki Stërmillit, tek Mariana e “Natë me hënë” e Kadaresë e deri tek “Ëngjëj të armatosur” të Diana Çulit vijon të endet në kohë dhe në hapësirë, tragjikomedia e cënimit të personalitetit dhe dinjitetit të femrës, si një nga procedimet shoqërore më të lehta për tu kryer.

Pavarësisht se është shkruar në fillimet e shekullit të kaluar ditari i Dijes është aktual edhe sot në kohët moderne. Dëshpërimi dhe protesta e saj qëndrojnë ende si një apel: *“Kush mundet me më sigurve se nuk ka mijra femna që, tue kundrue mbas kafazit të dritares ose nëpërmjet perçes së hollë, nuk shprazin nga goja mija e mija tubëza vjershash për ata që u kalojnë pranë, pa ditë se kanë plagosë randë disa zemra të strukura brenda ose krijesave të dënume me burgim të përjetshëm? Oh, sa e sa vajzash, nga plasat e dyerve ose nga birat e kafazeve, ndjekin e përcjellin kalimtarë të rinj me rrafje të forta të zemrave që s’kanë*

*liri e të drejtë shkrimi e dashunimi, megjithëqë natyra edhe ato, sikurse meshkujt dhe ndoshta më shumë se ata, i ka pajue me ndjesitë e dashunisë.*

*Unë, po të isha djalë, do t'i tregojsha botës mashkullore se dora që përkund djepin asht ajo që e rrotullon boshtin e fatit të njerëzisë, sepse ajo dhe vetëm ajo drejton jetën kah horizontet e ndrituna ose të errëta. Por, mjerisht, s'jam djalë dhe si femër nuk mundem me e nxjerrë zanin”* (Stërmilli, 1995: 9, 11).

Në këtë sens nuk ka fare rëndësi se një femër e nëpërkëmbur, e dhunuar, e flijuar apo e pushkatuar e ka emrin Rozafë, Dije, Marianë apo Dorothe. E rëndësishme dhe më kryesorja është jeta dhe dinjiteti i tyre. Prandaj me shumë të drejtë një kritiku ynë i nderuar, gjyqi e Marianës tek “Natë me hënë” e konsideron si Gjyqi i Pafajësisë (Çausi, 1993: 143). I tillë është gjyqi i Dorotheas dhe pushkatimi i pakuptimtë e tragjik i saj. Të tillë janë gjyqet e vogla e të mëdha që ndodhin rëndom në jetën e përditshme. Këto gjyqe përveç se të tilla janë edhe krime monstruoze. Në këtë sens, romani “Ëngjëj të armatosur” është një tekst origjinal artistik që dëshmon dhe denoncon krime apo gjyqe të tilla dhe që, estetikisht, e ndihmojnë shoqërinë tonë të zbutet e të emancipohet, në mënyrë që jeta njerëzore të fitojë vlerën që ka dhe meriton të ketë.

### 3. Subjekti i interpretuar

Romani “Ëngjëj të armatosur” trajton ngjarje të ndodhura në Shqipërinë e Luftës së Dytë Botërore. Romani rrëfen jetën e banorëve të fshatrave të Himarës dhe ndalet kryesisht tek dashuria mes e Dorethea Gjiks dhe Aleks Lazarit, e cila është e destinuar të jetë një dashuri e ndërprerë dhe tragjike. Ajo ishte vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç, ndërsa ai njëzetë e pesë dhe të dy bënin pjesë në të njëjtin batalion. Dorethea kishte braktisur shkollën dhe të “fejuarin” në Tiranë, Leon Nastën, një nga figurat më të larta udhëheqëse të Luftës Nacional-Çlirimtare, për t’u bër pjesë e atij batalion, për të luftuar kundër pushtuesve, për t’u bashkuar me të vëllain dhe të rinjtë e tjerë, për të qenë shembull për vajzat e bregut. Dorethea ishte një vajzë plot ëndrra dhe pasione, përpiquej të ecte me frymën e kohës, të ishte aktive në abjentin ku ajo jetonte. Dorethea bëhet anëtare e batalionit të drejtuar nga Aleks, pa pyetur për paragjykimet e të tjerëve dhe dëshirën e së ëmës. Mes Doretheas dhe Aleksit lind një ndjenjë e sinqertë një pasion i madh, pa e ditur se ato do të bëhen pak më vonë alibia e tragjedisë së tyre. Dashuria e tyre lindi në ambientet ku ata jetonin e luftonin së bashku, lind aty ku ata përballeshin çdo çast me vdekjen, por pa e ditur se vdekja do t’ju vinte nga ajo ndjenjë e bukur që po përjetonin. Dorethea, siç e theksuam është një emër i

huazuar nga greqishtja e lashtë që do të thotë: dhuratë e zotit, pra është diçka që buron nga hyjnorja, kështu ishte edhe ajo një krijesë tokësore me një bukuri hyjnore, për t’u pasur zili nga të gjithë, me një karakter sa të brishtë aq edhe të fort e të moralshëm. Është krejt i qart roli tematik i saj në roman; ajo është heroina e thjeshtë që di dhe do të thyej tabu të vështira si askush tjetër. Ishte bërë pjesë e luftës dhe po jetonte një dashuri pasionante me komandantin e batalionit, shokun e saj të fëmijërisë, Aleks Lazarin. Të dy ishin të bukur, të zotët dhe të lakmuar nga pjestarët e tjerë të luftës. Dorethea lakmohej për bukurinë e saj fizike, për aftësitë komunikuese me të gjithë, për tërheqjen që shkaktonte tek meshkujt dhe mbi të gjitha për dashurinë e Aleksit, ndërsa, ai, për trimërinë, emrin dhe famën që gëzonte në mbarë krahinën dhe që tashmë kishte gjetur edhe po jetonte një dashuri plot pasion me të bukurën Dorethea. E gjithë kjo dashuri do të shkatërrohet nga prania e një dëshmitari ziliqar, spiunit Mark Zaharia, njerit prej personazheve më të skalitur të romanit. Ai kishte vënë re dashurinë që kishte lindur mes dy të rinjëve dhe i ndjek ata fshehurazi kur nisen për një mision lufte. Ai bëhet dëshmitar i marrëdhënies së tyre intime duke përjetuar bashkë me ta pasionin, dhe në të njëjtën kohë zilin që ndjen për Aleksin, mospërfilljen e Doretheas, përbuzjen dhe indiferencën që tregonin fshatarët për të dhe kënaqësinë që do të ndjente duke e shkatërruar këtë lidhje të fort mes dy të rinjëve. Lajmi përhapet shpejt dhe autoritetet më të larta të luftës marrin vendimin ta shkatërrojnë këtë dashuri e cila ka thyer rregullat morale të Luftës partizane. Anëtarët e trupit gjykues ishin pjesë aktive dhe të njohur në instancat e larta udhëheqëse në Qark. Ky trup gjykues kryesohej nga Demir Hasani dhe i përbëhej nga Agime Resuli dhe shokë të tjerë të dy të rinjëve. Gjithshka është një farsë, një tragjikomedi ku të pamoralshmit gjykojnë të moralshmit dhe të pafajshmit. Demir Hasani dhe Agime Resuli janë ndër personazhet më realizuara të romanit. Seicili prej tyre nga interesa dhe këndvështrime të ndryshme shpalosin karakterin e errët, negativ e bizantin. Gjyqi zhvillohet në një manastir të vjetër dhe zgjat shtatë ditë. Akuzat e para bien mbi Dorethean për krimin e rëndë që kishte kryer, se kishte thyer rregullat e luftës kishte bërë dashuri me “shokun” Aleks, kishte tradhëtuar të fejuarin e saj në Tiranë dhe kishte sjellë një shembull të papajtueshëm me normat morale të asaj shoqërie dhe nuk mund të lejohej ekzistenca e saj në ato ambiente. Gjyqi i zhvilluar në shtatë seanca do të ishte fatal për Dorethean, e cila në të njëjtën kohë po vuante dëshirën e madhe për t’u hedhur sërish në krahët e Aleksit, në krahët e atij, tek i cili përjetoi lumturinë e

vërtetë, ndjeu dashurinë e vërtetë. Por vendimi i marrë nga trupi gjykues ishte fatal vetëm për Dorethean, ajo u dënua me vdekje për tradhëti të dyfishtë, thyerje të rregullave të luftës dhe tradhëti ndaj të fejuarit të saj, shokut Leon Nasta. Ndërsa, Aleks i dënohet me shkarkim nga detyra, për shkak të përkrahjes që ai gëzonte në popull dhe famës që kishte si një luftëtar i zoti dhe mundi t'i shpëtonte pushkatimit. Nuk mundi të kishte të njëjtin fat edhe e dashura e tij e zemrës. Ai dhe shokët e tjerë do të ishin dëshmitarë të pushkatimit mizor të Doretheas.

#### 4. Përfundime

Pavarësisht se, siç na njofton vetë autorja, romani e ka pikënisjen nga një ngjarje reale e ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore, ngjarje që në të vërtetë është vlerësuar herëpashere në ambjentin shqiptar si një love story në mesin e luftës, romani është fund e krye një fiction, një tekst letrar i menduar e përpunuar bukur estetikisht. Në themel të romanit qëndrojnë marrëdhëniet e dy të rinjve, Dorotheas dhe Aleksit, dhe prej këtij relacioni vihet në perspektivë i tërë aksioni i tij, përmes disa linjave të përcaktuara qartë, të cilat, me një ritëm të saktë, "lëshohen dhe tërhiqen" në varësi të tensionit dramatik dhe metamorfozës së intrigës. Rreth figurës së Dorotheas e cila është strumbullari i veprës, afrohen dhe largohen sipas rastit, psikologji, karaktere dhe morale të ndryshme, që përfaqësohen nga personazhet e tjerë të veprës. Dorothea Gjika përfaqëson sfidën e vonuar të femrës shqiptare të shekullit të kaluar. Ajo përmbush me sukses misionin që Rozafa nuk mund ta kryente, misionin që Dija dhe simotrat e saj vetëm e ëndërronin. Sfida e Dorotheas është e shumëfishtë sepse ajo hyn në konflikt me të fejuarin zyrtar të saj, Leon Nastën, me familjen, me opinionin apo moralin patriarkal mashkullor, me individe ziliqare e hakmarrëse të gjinisë e saj Agime Resulin dhe së fundi me ligjet e normat morale të pashkruara të Luftës, Demir Hasanin i cili përfaqëson në miniaturë tipin e shtetarit kriminel dhe vrasës. Në luftë për të kryer misionin dhe sfidën e saj nuk mund të ketë kthim prapa. Duket sikur çdo gjë është paracaktuar, jo prej vullnetit të perëndive si në tragjeditë e antikitetit, por prej njerëzve real, tokësor që kanë diku-diku pushtetin e vendimmarrjes pseudoligjore e politike, diku pushtetin e thashethemit e denoncimit dhe diku-diku atë të indiferencës tipike shqiptare. Lidhur me këtë komponente të romanit me të drejtë kritikun Virgjil Muçi shprehet se: "Si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje, "Engjëjt..." e Çulit ka diçka nga tragjeditë e antikitetit. Pikësëpari Fati dhe Fataliteti që u vigjillojnë mbi krye dhe shoqërojnë si Dorothenë dhe Aleksin, ashtu edhe personazhet e tjerë në dramën e tyre të

jetës e të vdekjes, duke na kumtuar se gjithçka është e parashkruar dhe kurrkush nuk mund t'u imponohet Mojrave e të këmbejë fatet tona. Vetë struktura e romanit, me personazhet që shfaqen e zhduken për t'u rishfaqur sërish si në një skenë antike, i vjen në ndihmë kësaj gjëje" (Muçi: [www.floart-press.blogspot.com](http://www.floart-press.blogspot.com)).

Por Dorothea, e ndërgjegjshme ose e pandërgjegjshme për fatin tragjik që e pret, gjithësesi lufton para së gjithash për lirinë, lunturinë dhe dashurinë e saj personale, respekton pasionin dhe ndjenjat e saj duke mos i përfillur konvencionet morale e zyrtare të kohës. Në këtë kontekst ajo përfaqëson heroinën që thyen normat morale të shoqërisë duke u kthyer në një model emancipimi dhe qytetërimi jo vetëm për pjesën femërore por për gjithë shoqërinë. Dorothea nuk është thjesht një vajzë e pafajshme dhe e dëlirë, që dashuron kur nuk duhet ta bëjë këtë; ajo është model dhe vlerë në kufijtë e përsosmërisë, është natyrë e pastër njerëzore, e virgjër shpirtërisht dhe moralisht, ëndërrimtare dhe shpresëdhënë, burim lumturie dhe gëzimi por dhe burim dhimbjeje, drame dhe vuajtjeje. Këto tipare thelbësore të një mentaliteti të ri shoqëror, të mishëruara në figurën e Dorothea Gjikes, kanë sjellë si rezultat faktin që në roman të përvijohen dy kampe të fuqishme personazhesh që në mënyrë simbolike përfaqësojnë dhe sugjerojnë respektivisht dashurinë dhe urrejtjen, mirësinë dhe ligësinë, parimin dhe urrejtjes aktorët si Demir Hasani, Agime Resuli, Luiza etj. në emër të moralit, ligjit dhe parimit luajnë në mënyrë perfekte tragjedinë djallëzore të një krimi pa shkak i cili nuk merr fund këtu. Triumfi i tyre mbi Dorothean dhe Aleksin është në të vërtetë uvertura e përvijimit të një sistemi kriminal që do të konturohej pak vite më vonë, në trajtën e shtetit totalitar.

Dorothea nuk vritet në luftë, nuk është viktimë e një beteje ushtarake, nuk është një heroinë partizane e ndrydhur, askete, luftëtare apo makinë lufte siç jemi mësuar rëndom t'i ndeshim ato në dhjetra-qindra tekste socrealiste. Në mënyrë absurde atë e vrasin shokët e saj, e fajësojnë pa patur faj, e pushkatojnë mizorisht pas një gjyqi fars të disa njerëzve që kushedi se përse (madje nuk ka asnjë arsye) të quhet trup gjykues. Në këtë kontekst Dorothea Gjika por edhe Aleks Lazari janë karaktere unike, janë protagonistë të një tendence të re etiko-morale që, në një shoqëri si e jona mund të lindi shpejt, por që qytetarizohet dhe konsolidohet me vështirësi e sakrifica të mëdha. Kjo tendencë e re etiko-morale e cila nuk përqafohet me lehtësi nga shoqëria, paragjykohet, dënohet dhe ekzekutohet nga kampi i errët shoqëror, i përfaqësuar nga Demir Hasani, ose thënë ndryshe, demiurgu i së keqes. Vetë autorja e romanit, duke folur për shkaqet

e këtij krimi, shprehet se: “Engjëj të armatosur” është një roman ku vdekja e një personazhi-grua, viktimë e mentalitetit të egër, e **solidaritetit mashkullor** (theksimi me bold është i yni) e intrigave, e xhelozisë, e zilisë dhe e etjes për karrierë i qëndron lexuesit para syve, që në faqen e parë, si një ankth, i cili thellohet gjithnjë e më shumë” (Çuli: <http://www.forumi.zemrashqiptare.net>) Nisur nga faktet dhe lënda e romanit kemi të drejtën të zgjerojmë këtë arsytim të autores dhe të artikulojmë se, për fatin e keq, Dorothea Gjika është viktimë jo vetëm e solidaritetit mashkullor. Mund të pohojmë se ajo është viktimë e solidaritetit të përbashkët mashkullor dhe femëror, një rast ky ndoshta unikal së paku në letërsinë tonë, (madje dhe në jetën e përditshme), kur burra dhe gra, për motive nga më të ndryshmet, angazhohen në një aksion kaq kriminal, të denjë vetëm për situata pushtimi dhe genocidi. Këtij pohimi i vijnë në ndihmë dhjetra faqe të romanit në të cilat, autorja me një mjeshtëri të dallueshme dhe të spikatur, përshkruan psikologjinë e brendshme të Agime Resultit dhe Luizës, tek të cilat, karakteri malinj, zilia, cmira dhe egoizmi i tyre shfaqen shumëfish, madje më të forta se ato të burrave. Por, për çudinë e të gjithëve, edhe pasi realizuan pushkatimin, koalicioni

i përbashkët mashkullor dhe femëror i së keqes, nuk mundi dot të përjetojë “gëzimin e fitores dhe triumfit”. Ndërkaq Dorothea i kishte sfiduar qoftë edhe me vdekjen, ashtu siç i kishte sfiduar në jetën reale. Në këtë pikëpamje, “Engjëj të armatosur” i Diana Çulit që për hir të së vërtetës artistike, sipas mendimit tonë, është romani më i mirë i saj, përfton formatin e një poeme për femrën, dashurinë dhe emancipimin. Romani është homazh dhe himn për ndjenjat e pastra njerëzore të porealizuara, për shkak të rrethanave shoqërore, duke na pohuar kështu të vërtetën se absurditeti i tragjedisë së Zhuljetës së Shekspirit nuk është asgjë në krahasim me absurdin kriminal që përjetoj Dorothea jonë shqiptare.

#### **Bibliografia**

- ÇAUSHI, Tefik (1993), *Universi letrar i Kadaresë*, “Dituria”, Tiranë.
- ÇULI, Diana, <http://forumi.zemrashqiptare.net>.
- ÇULI, Diana (2004), “Engjëj të armatosur”, roman, “Besa”, Tiranë.
- DONNA (), tema centrale, [www.exbaba.it/alkune](http://www.exbaba.it/alkune).
- MUÇI, Virgjil (), [www.floart-press.blogspot.com](http://www.floart-press.blogspot.com)
- STËRMILLI, Haki (1995), *Sikur të isha djalë*, roman, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë.